



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 53/Prot.
5

Tiranë, më 23.12.2022

V E N D I M

Nr. 164, datë, ____ . 23.12.2022

PËR DHËNIE MASË DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tunj, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Merita Selimi, nr.10191, datë 25.11.2022, dhe kërkesës shtesë, datë 05.12.2022 “Për procedimin disiplinor të oficerit të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Lazar Tunj , protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore me numer protokoll 53,, datë 30.11.2022 dhe nr.53/1, datë 05.12.2022 dhe analizoi çështjen, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.152, datë 07.12.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Lazar Tunj, për kryerjen e shkeljeve disiplinore, të parashikuara nga neni 33, pika 3, gërmat “d”, dhe pika 4, gërma ”ç”, të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Merita Selimi dhe dokumentat që e shoqërojnë atë, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Lazar Tunj , në shkelje të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të cilat rregullojnë dhe garantojnë procedim penal, të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor , si dhe

dispozitave që parashikojnë detyrimin e subjekteve që kryejnë ndjekjen penale dhe kryejnë hetimet, për respektimin e normave procedurjale penale.

3. Nga aktet e administruara gjatë procedimit disiplinor dhe në seancë dëgjimore ka rezultuar se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë në datën 10.06.2021, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Izmir Kuçi, ka regjistruar procedimin penal Nr. 329 për figurën e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal.

Për kryerjen e veprimeve hetimore për këtë çështje është ngarkuar oficeri Policisë Gjyqësore Lazar Tuni.

3.1 Ne datën 21.11.2021 është paraqitur ne Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë shtetasja Brunilda Dinaku, e cila kerkonte te dinte statusin juridik ne hetimin e ceshtjes penale me kallzues shtetasin Izmir Kuci. Në kerkesën e saj kjo shtetase parashtronte se për këtë procedim penal, është pyetur si person që tregon rrethanat e hetimit, nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tuni. Në datën 08.11.2022 i është kërkuar nëpërmjet sms, në rubriken "Mesagges " në numrin e saj te telefonit 0685357610, të paraqitet në Prokurori në oren 2, për tu pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet për rastin e Izmir Kucit, duke i bërë me dije të drejtën për tu paraqitur me avokat.

Shtetasja Brunilda Dinaku është paraqitur në datën e dhe oren e caktua, por nuk është pyetur, sepse oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tuni nuk ka qenë në zyrën e tij në ditën dhe orarin e caktuar, po prej tij.

3.2 Në vlerësim të kërkesës së shtetasës Brunilda Dinaku, Prokuroria e çështjes, Merita Selimi ka kërkuar informacion nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tuni për veprimet hetimore të kryera dhe dorëzimin e fashikullit të procedimit penal. Pas dorëzimit të fashikullit të hetimit, prokurorja ka konstatuar në dosje, tre urdher thirje për shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Orgest Hoxha si dhe një procesverbal kqyrje marrje prove, datë 15.06.2022. Në dosje nuk janë administruar procesverbale të pyetjes së shtetasve të sipërpërmendur, dhe nuk rezultojne fletë thirje për pyetjen e tyre në datën 19.07.2022.

3.3 Në këto rrethana, me urdhër të prokurorit, në datën 24.11.2022 është bere këqyrja e telefonit te shtetasës Brunilda Dinaku nga oficeri i Policisë Gjyqësore Ylber Zogaj.

Nga kqyrja e telefonit të shtetasës Brunilda Dinaku evidentohet një sms e dërguar nga numri i telefonit 0695822783, ku prezantohet oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tuni, me përmbajtje *"Në oren 2 ju pres ne zyren per tu pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet me rastin e Izmir Kucit; Keni te drejten per tu asistuar edhe nga nje avo/cat mbrojterws. Lazar Tuni."*

3.4 Ne date 25.11.202 është berë keqyrja e telefonave celular edhe për shtetasit Ina Bajaziti dhe Francesko Topi. Nga kqyrja rezulton se i njëti mesazh, me të njëjtën përmbajtje, nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tuni, u është dërguar dhe këtyre shtetasve. Shtetasit e përmendur më lart, megjithese jane paraqitur të shoqëruar me

avokat, nuk janë pyetur nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, duke e lene per nje date tjeter.

Në relacionin shoqërues, prokurorja Merita Selimi, parashtron se jgatë hetimit të proçedimit penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lazar Tuna, nuk është paqitur ndonjë informacion përmlledhës për veprimet hetimore që ai ka kryer për proçedimin penal dhe nuk ka bërë ndonjë sygjjerim për përgjegjësinë penale të personave konkret. Urdhëri për regjistrimin e emrit të personit si person nën hetim, është atribut vetëm e prokurorit. Meqënsë për këtë proçedim penal nuk ka urdhër të prokurorit për regjistrimin e ndonjë emëri si autor i veprës penale , thirja nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lazar Tunj e shtetasve Brunilda Dinaku, Ina Bajaziti dhe Françesko Topi, me cilësinë e personave nën hetim, përbën shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

3.5 Këto veprime dhe shkelje të kërkesave ligjore dhe proçedurjale, të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësorë Lazar Tunj , nga ana e Prokurorit Merita Selimi, konsiderohen si shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 3, gërma “d” dhe pika 4, gërma ”ç” , në formën,

- “Fakte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore” dhe

- “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”,

4. Konkluzione të Komisionit të Policisë Gjyqësore

4.1 Lidhur me shkeljet disiplinore që i atribuhone ofocerit të Policisë Gjyqësore, shumica e Komisionit (4 anëtar pro dhe 1 kundra) arriti në konkluzionin se shkeljet disiplinore qëndrojnë dhe se ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Lazar Tunj duhet të aplikohen masa disiplinore.

Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre, shjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, u provua se gjatë hetimit të proçedimit penale nr. Nr. 329, regjistruar në datën 10.06.2021 për figurën e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tunj, janë shkelur kërkesat e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” dhe dispozitat e Kodit të Proçedurës Penale që garantojnë proçesin e rregullt ligjor gjatë hetimit, respektimin e të drejtave proçedurale të subjekteve të përfshirë në nje hetim penal dhe ndaj të cilëve kryen veprime procedurjale, Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore në kuadër të këtij proçedimi penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lazar Tunj janë shkelur kërkesat e neni 2 të Kodit të Proçedurës Penale, i cili përcakton detyrimin që kanë subjektet e proçedimit penal, organet shtetërore, personat juridik dhe shtetasit për të zbatuar dispozitat e këtij Kodi për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale. Janë shkelur kërkesat e neneve 30, 132 e 134 të Kodit të Proçedurës Penale dhe nenet 3, 5 dhe 7 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të cilat parashikojnë funksionet e Policisë Gjyqësore, dhe përcaktojnë parimet nga të cilat duhet të udhëhiqen oficerët e Policisë Gjyqësore në ushtrimin e veprimtarisë hetimore, sikurse janë

parimi i ligjshmërisë dhe parimi i objektivitetit dhe paanshmërisë, shkelje këto që sjellin pasoja për ecurinë e procedimit penal dhe cënim të të drejtave dhe interesave të shtetasve që bëhen pjesë e një procedimi penal.

4.2 U provua se thirja me sms e shtetasve Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Orgest Hoxha është në kundërshtim me kërkesat e neneve 132,133 e 134 të Kodit të Procedurës Penale dhe në shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe objektivitetit në hetim, të parashikuar nga neni 3 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti janë thirur nga oficeri i Policisë Gjyqësore nën një cilësi, (si persona nën hetim), të cilën nuk e kishin në këtë faze procedimit penal. Dhënia e cilësisë person nën hetim, është atribut i prokurorit, i cili, referuar Kushtetutës së Shqipërisë, dhe ligjeve të dala në zbatim të saj, është autoriteti i vetëm që ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë dhe për pasojë përcakton dhe statusin e subjekteve që përfshihen në një procedim penal, dëshmitar, person nën hetim apo i pandehur.

Me thirjen e shtetasve të sipërmendur si persona nën hetim, oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tunj ka dale jashtë kompetencave dhe detyrave që i ngarkon Kodi i Procedurës Penale, ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” dhe ka marrë atributet e prokurorit të çështjes.

Veç sa sipër, thirja e shtetasve Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti me sms është bërë në kundërshtim me nenet 132,133 e 134 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat parashikojnë mjetet dhe format e njoftimit. Neni 133 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon si një nga format e njoftimit, njoftimin me anë të telefonit, përfshirë dhe sms, por këtë formë njoftimi, Kodi e kushtëson me egzistencën e rastit të ngutshëm. Nga aktet e dosjes nuk rezulton ndonjë rast i ngutshëm, që oficerii policisë gjyqësore Lazar Tunj, të shmangte format e zakonshme të njoftimit dhe të detyrohej për të thirur shtetasit e sipërmendur me sms.

5. Shumica e Komisioni të Policisë Gjyqësore, duke ju referuar në parashikimeve që ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, në nenin 33, bën për shkeljet disiplinore, veprimet dhe sjelljet që konsiderohen shkelje disiplinore, natyrën e tyre dhe pasojat që duhet të sjellin, vlerëson se shkelja e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe kërkesave të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, që parashikojnë funksionet e Policisë Gjyqësore dhe garantojnë procesin e rregullt ligjor gjatë hetimit, respektimin e të drejtave procedurale të subjekteve të përfshirë në një hetim penal, dhe ndaj të cilëve kryen veprime proceduriale, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tunj, janë shumë të rënda dhe për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që kanë sjellë, përbëjnë shkelje disiplinore, në formën e: **“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”**, të parashikuar nga neni 33, pika 4 gërmat “ç” e të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Me këto veprime, oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, ka cënuar rëndë parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe parimet e një hetimi objektiv, të plotë dhe të paanshëm. Të vepruarit në këtë mënyrë, në kundërshtim të hapur me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale, shkatëron hetimin e çështjes.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, e di se duke thirur personin me një cilësi tjetër nga ajo që duhet thirur sipas rrethanave dhe provave të grumbulluar deri në atë moment të hetimit,

cënon marrjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për hetimin dhe zbardhjen e çështjes. Megjithëse është i qartë për cilësin dhe statusin që kishin shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti deri në këtë fazë të procedimit penal, i ka thirrur këta shtetas si persona nën hetim, në një kohë që ata duhet të thirreshin për tu pyetur si persona që kanë dijeni për rrethanat e ngjarjes (dëshmitar).

5.1 Gjithashtu, shumica e Komisioni të Policisë Gjyqësore, vlerëson se shkeljet e sipërcituara, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tunj, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që kanë sjellë, përbëjnë dhe shkelje disiplinore, në formën e: ***“fakte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore”***, të parashikuar nga neni 33, pika 3 gërmat “d” e të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Të dhënat dhe provat e administruara gjatë procedimit disiplinore, evidentojnë faktin se gjatë ndjekjes së procedimit penal nr .329, regjistruar në datën 10.06.2021, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tunj janë kryer veprime të cilat diskreditojnë rëndë figurën e oficerit të policisë gjyqësore. Oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tunj, ka thirrur shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti, si persona nën hetim, cilësi të cilën ata nuk e kishin dhe kjo cilësi i vendoste ata nën presion, dhe për më tepër që një cilësi e tillë nuk u ishte caktuar dhe as u ishte bërë e ditur nga prokurori. Këto veprime e sjellje të oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tunj, referuar perceptimit që ka krijuar te personat e thirrur, janë kompromentuese dhe përbëjnë akte e sjellje të cilat diskreditojnë rëndë figurën e oficerit të policisë gjyqësore.

Këto veprime çënojnë rëndë imazhin e Policisë Gjyqësore, duke kompromentuar objektivitetin dhe panashmërinë e Policisë Gjyqësore në hetimin penal. Me këto veprime është çënohet rëndë në publik imazhi i oficerit të policisë gjyqësore si individ dhe i Policisë Gjyqësore, pasi veprimet e tij kanë krijuar perceptimin tek shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti se marrja e personave nën hetim apo të pandehur janë diskrecion i lirë i oficerit të Policisë Gjyqësore, jo në pajtim me ligjin, por sipas vullnetit të tij jashtë ligjit.

5.2 Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Lazar Tunj shpjegoi se nuk i pranon ato, se ka vepruar në përputhje me ligjin, se kjo është një praktikë pune e ndjekur dhe për raste të tjera, se nuk ka konstatuar vullnet te prokurori çështjes për të vënë para përgjegjësisë penale personat përgjegjës, se i ka thirrur si persona nën hetim, në funksion të taktikës që ai ka menduar të ndjekë për hetimin e çështjes, etj.

Shpjegimet dhe pretendimet e oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tunj, se nga ana e tij nuk janë kryer shkeljet disiplinore që i atribuohen, nuk qëndrojnë dhe nuk justifikojnë shkeljet e kryera prej tij. Sikurse u parashtrua më lartë, me provat që u administruar gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor, u provua plotësisht se prej tij janë kryer shkeljet disiplinore të cilat i atribuohen.

6. Duke i konsideruar të provuara shkeljet disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tunj, shumica e Komisionit, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33, i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta:

- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “d” pika 3 e nenit 33 të ligjit, parashikon si **shkelje të rëndë**, *“fakte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore”*. Ndërsa në pikën 4 të këtij neni, në gërmën “ç”, ky ligj parashikon si **shkelje shumë të rëndë**, *“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”*

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Lazar Tunj, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljeve disiplinore të kryera prej tij, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit dhe parashikimet e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas rradhës, **a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në në vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.**

Në pikën 3 të nenit 34 parashikohet që për shkeljet e rënda jepet masa disiplinore “ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në në vit.

Ndërsa, në pikën 4 të nenit 34, në gërmat “ç” dhe “d” parashikohet që për shkeljet shumë të rënda, jepen masat disiplinore “pezellim nga detyra deri në 6 muaj”, ose “largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të”.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se në rastin objekt shqyrtimi, janë konsumuar dy shkelje disiplinore nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, nga të cilat, njëri ligji 25/2019 e klasifikon shkelje të rëndë dhe tjetër shumë të rëndë. Në raste të tilla, kur ka konkurim të shkeljeve disiplinore dhe shkeljeve të konstatuara u përkojnë masa të ndryshme disiplinore, bazuar në nenin 1, pikat 5 dhe 6 të Rregullores nr.1, datë 21.04.2020 “Për proçedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, Komisioni duhet të japë një masë të vetme disiplinore, masën më të rëndë.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon se ndaj oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tunj duhet të japë njëri nga masat disiplinore të parashikuara nga neni 34 i ligjit 25/2019 ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, për shkeljet disiplinore shumë të rënda, “pezellim nga detyra deri në 6 muaj”, ose “largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të”.

Lidhur me masën disiplinore që duhet ti jepet Oficerit të Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, anëtarët e Komisionit u ndanë në mendimet e tyre. Anëtarë Albert Muça votoi për mosdhënie mase disiplinore ndaj oficerit Lazar Tunj, sepse për mendimin e tij, shkeljet e konstatuara nuk përbëjnë shkelje disiplinore. Kryetari Komisionit është i mendimin dhe dha votën për masën disiplinore “largim nga detyra”. Ndërsa shumica e Komisionit e përbërë nga anëtarët Arjan Muça, Hari Goga dhe Redi Vasili, votuan për masën disiplinore “pezellim nga detyra për 6 muaj”,

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4, nenit 33, pika 3, gërma “d”, pika 4, gërma “ç”, neni 34, pika 1, gërma “ç”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore **Lazar Tuni**, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, i jepet masa disiplinore “pezullim nga detyra për 6 muaj”,
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tuni , i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Merita Selimi.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tuni.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

Në // pakicë

ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO

Në // pakicë



MENDIM PAKICE

Nuk jam dakort me zgjidhjen që shumica i dha procedimit disiplinor ndaj oficerit të Policisë Gjqësore Lazar Tuni lidhur me lloin e masës disiplinore për arsyet e mëposhtme:

Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Merita Selimi, Komisioni i Policisë Gjqësore, me Urdhërin nr.152, datë 07.12.2022 ka urdhëruar fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Lazar Tuni, për kryerjen e shkeljeve disiplinore, të parashikuara nga neni 33, pika 3, gërmat “d”, dhe pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjqësore” dhe zhvilloi seancën dëgjimore ku u administruan provat e paraqitura nga subjekti propozues dhe oficeri i Policisë Gjqësore Lazar Tuni.

2. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, analiza e tyre, shjegimet e vetë subjektit të procedimit disiplinor, u provua se gjatë hetimit të procedimit penale nr. Nr. 329, regjistruar në datën 10.06.2021 për figurën e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, nga ana e oficerit të policisë gjqësore Lazar Tuni, janë shkelur kërkesat e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjqësore” dhe dispozitat e Kodit të Proçedurës Penale që garantojnë procesin e rregullt ligjor gjatë hetimit, respektimin e të drejtave procedurale të subjekteve të përfshirë në një hetim penal dhe ndaj të cilëve kryen veprime procedurjale. Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore në kuadër të këtij procedimi penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjqësore Lazar Tuni janë shkelur kërkesat e nenit 2 të Kodit të Proçedurës Penale, i cili, përcakton detyrimin që kanë subjektet e procedimit penal, organet shtetërore, personat juridik dhe shtetasit për të zbatuar dispozitat e këtij Kodi për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale. Janë shkelur kërkesat e neneve 30, 132 e 134 të Kodit të Proçedurës Penale dhe nenet 3, 5 dhe 7 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjqësore”, të cilat parashikojnë funksionet e Policisë Gjqësore, dhe përcaktojnë parimet nga të cilat duhet të udhëhiqen oficerët e Policisë Gjqësore në ushtrimin e veprimtarisë hetimore, sikurse janë parimi i ligjshmërisë dhe parimi i objektivitetit dhe paanshmërisë, shkelje këto që sjellin pasoja për ecurinë e procedimit penal dhe cënim të të drejtave dhe interesave të shtetasve që bëhen pjesë e një procedimi penal.

3. U provua se oficeri i Policisë Gjqësore Lazar Tuni, ka thirrur shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti si persona nën hetim, cilësi të cilën nuk e kishin në këtë procedim penal. Në telefonat e tyre ka mbëritur sms e dërguar nga oficeri i Policisë Gjqësore Lazar Tuni, me përmbajtje, *‘Ne oren 2 ju pres ne zyren per tu pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetimet me rastin e lzmir Kucit;Keni te drejten per tu asistuar edhe nga nje avo/cat mbrojterws. Lazar Tuni.’*

Shtetasit e sipërcituar, janë paraqitur, ne daten dhe oren e caktuar, por nuk janë pyetur, sepse oficeri i Policisë Gjqësore Lazar Tuni nuk ka qenë në zyrën e tij në ditën dhe orarin e caktuar, po prej tij.

Thirja me sms e shtetasve Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti është në kundërshtim me kërkesat e neneve 132,133 e 134 të Kodit të Proçedurës Penale dhe në shkelje

të parimit të ligjshmërisë dhe objektivitetit në hetim, të parashikuar nga neni 3 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Me thirjen e shtetasve të siërpërmendur si persona nën hetim, oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tunj ka dal jashtë kompetencave dhe detyrave që i ngarkon Kodi i Proçedurës Penale , ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” dhe ka marrë atributet e prokurorit të çështjes. Dhënia e cilësisë person nën hetim, është atribut i prokurorit, i cili, referuar Kushtetutës së Shqipërisë, dhe ligjeve të dala në zbatim të saj, është autoriteti i vetëm që ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë dhe për pasojë përcakton dhe statusin e subjekteve që përfshihen në një proçedim penal, dëshmitar, person nën hetim apo i pandehur.

4. Me të drejtë shumica e Komisioni të Policisë Gjyqësore, ka arritur në konkluzionin se, duke ju referuar parashikimeve që ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, bën për shkeljet disiplinore, veprimet dhe sjelljet që konsiderohen shkelje disiplinore, natyrën e tyre dhe pasojat që duhet të sjellin , shkelja e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe kërkesave të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Lazar Tunj, janë shumë të rënda dhe për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që kanë sjellë, përbëjnë shkelje disiplinore, në formën e: **“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasojat për hetimin e çështjes”**, të parashikuar nga neni 33, pika 4 gërmat “ç” e të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Me këto veprime, oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, ka cënuar rëndë parimet e një proçesi të rregullt ligjor dhe parimin e një hetimi objektiv, të plotë dhe të paanshëm. Të vepruarit në këtë mënyrë, në kundërshtim të hapur me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Kodi i Proçedurës Penale, shkatërron hetimin e çështjes.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, e di se duke thirur personin me një cilësi tjetër nga ajo që duhet thirur sipas rrethanave dhe provave të grumbulluar deri në atë moment të hetimit, cënon marrjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për hetimin dhe zbardhjen e çështjes

Gjithashtu, jam dakort me konkluzionin e Komisionit se këto shkelje, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që kanë sjellë, përbmbajnë dhe elementët e shkeljes disiplinore: **“fakte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore”**, të parashikuar nga neni 33, pika 3 gërmat “d” e të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Veprimet në kundërshtim me ligjin të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, diskreditojnë rëndë figurën e oficerit të policisë gjyqësore. Thirja në prokurori e shtetasve Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti, si persona nën hetim, cilësi të cilën ata nuk e kishin, i ka vendosur ata nën presion, dhe për më tepër që një cilësi e tillë nuk u ishte caktuar dhe as u ishte bërë e ditur nga prokurori. Për këtë arsye këta shtetas i janë drejtuar prokurores së çështjes për të mësuar statusin e tyre në proçedimin penal. Këto veprime e sjellje të oficerit të policisë gjyqësore Lazar Tunj, referuar perceptimit që ka krijuar te personat e thirur, janë kompromentuese dhe përbëjnë akte e sjellje të cilat diskreditojnë rëndë figurën e oficerit të policisë gjyqësore.

5. Kam mendimin se shumica ka gabuar duke i caktuar oficerit të Policisë Gjyqësore masën disiplinore “Pezullim nga detyra për 6 muaj”. Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, kërkon që Komisioni në dhënien e vendimit dhe caktimin e masës disiplinore, duhet të marrë parasysh llojin dhe natyrën e shkeljes, rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore, rrethanat dhe faktorët lehtësues dhe rënduese, qëndrimin e oficerit të Policisë Gjyqësore ndaj shkeljes së kryer, pasojat e shkaktuara, përvoja dhe rezultatet individuale në ushtrimin e detyrës, etj.

Duke patur parasysh këto rrethana, rezulton se masa disiplinore e dhënë “Pezullim nga detyra për 6 muaj”, nuk është në proporcionalitet me shkeljet e kryera.

- Shkeljet disiplinore për të cilat procedohet Oficeri i Policisë Gjyqësore, Lazar Tunj, për vetë mardhëniet që çënojnë dhe pasojat që sjellin, klasifikohen nga ligji, nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të rënda dhe shumë të rënda.

Mënyra si ka vepruar dhe rrethanat në të cilat ka kryer shkeljen dhe sidomos pasojat që ato kanë sjellë, i bëjnë ato tepër të rënda

Me thirjen e shtetasve Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti si persona nën hetim, oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, ka çënuar rëndë parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe parimin e një hetimi objektiv, të plotë dhe të paanshëm. Të vepruarit në këtë mënyrë, në kundërshtim të hapur me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale, shkatëron hetimin e çështjes.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj, e di se duke thirrur personin me një cilësi tjetër nga ajo që duhet thirrur sipas rrethanave dhe provave të grumbulluar deri në atë moment të hetimit, çënon marrjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për hetimin dhe zbardhjen e çështjes. Megjithëse është i qartë për cilësinë dhe statusin që kishin shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti, me ndërgjegje të plotë, i ka thirrur këta shtetas si persona nën hetim në një kohë që ata duhet të thirreshin për tu pyetur si persona që kanë dijëni për rrethanat e ngjarjes (dëshmitar).

- Gjithashtu me këto veprime, oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj ka çënuar rëndë imazhin e Policisë Gjyqësore, duke kompromentuar objektivitetin dhe panashmërinë e saj në hetimin penal. Me këto veprime është çënuar rëndë në publik imazhi i oficerit të policisë gjyqësore si individ dhe i Policisë Gjyqësore në tërësi, sepse veprimet e tij kanë krijuar perceptimin tek shtetasit Brunilda Dinaku, Françesko Topi dhe Ina Bajaziti se marrja e personave nën hetim apo të pandehur janë diskrecion i lirë i oficerit të Policisë Gjyqësore, jo në pajtim me ligjin, por sipas vullnetit të tij jashtë ligjit.

- Gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor, nuk u evidentua prania e ndonjë faktori apo rrethane lehtësuese që do të ndikonte në lehtësimin e pozitës së oficerit të Policisë Gjyqësore Lazar Tunj në raport me shkeljet disiplinore të kryera. Gjithashtu u evidentua se për vitin 2021, për performancën dhe rezultatet individuale në punë, mbi bazën e vlerësimit të paraqitur nga drejtuesi i prokurorisë, vlerësimi i tij është klasifikuar nga Komisioni në kategorinë “mjaftueshëm”.

- Pozita e oficerit të Policisë Gjyqësore Lazar Tunj në raport me shkeljet disiplinore që ka kryer, rëndohet dhe nga qëndrimi që ai mban ndaj këtyre shkeljeve. Në séance dëgjimore, oficeri i Policisë Gjyqësore Lazar Tunj jo vetëm që nuk i pranon ato, por u mundua ti shjegojë si një praktikë pune të zakonshme dhe si pjesë e taktikës që ai ka ndërtuar për hetimin e çështjes.

Ky qëndrim i tij, dhe kjo mënyrë e të kuptuarit dhe të vepruarit të hetimit, jo vetëm që cënon rëndë parimet e procesit të rregullt ligjor dhe hetimit objektiv, të plotë dhe të paanshëm, por tregon dhe pamjaftueshmëri të theksuar profesionale të tij, mosnjohje të parimeve ligjore që duhet të ndiqen gjatë hetimit të veprave penale.

Ndodhur para këtyre rrethanave, dhe duke patur parasysh ligjin 25/2019 ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i cili në nenin 34, për shkeljen disiplinore *“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasojë për hetimin e çështjes”*, parashikon si masa disiplinore *“pezullimin nga detyra deri në 6 muaj”*, ose *“largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të”*, mendoj se masa më e përshtatshme dhe në propocionalitet me shkeljet e kryera, do të ishte masa disiplinore **“largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të”**.

Kryetari i Komisionit të Policisë Gjyqësore

Alfred PROGONATI

